

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE
ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ ОПШТЕСТВЕНИ НАУКИ
FACULTY OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES

STUDIME PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEZA:

**TEKNOLOGJIA INFORMATIVE NË FUNKSION TË
QEVERISJES SË MIRË NË RMV**

Kandidati:
Bestar Zeqiri

Mentori:
Prof.Dr. Agron Rustemi

Tetovë, 2020

Deklaratë

Unë, Prof. Fexhide Zeqiri, profesoreshë e **Gjuhës dhe letërsisë shqipe**, në Gjimnazin “Kiril Pejçinoviç”-Tetovë, deklaroj se punimi i magjistraturës **“Teknologjia informative në funksion të qeverisjes së mirë në RMV”** është i lekturuar dhe në aspektin gjuhësor i plotëson të gjitha kushtet sipas drejtshkrimit të shqipes standarde.

Këtë deklaratë e jap me kërkesë të kandidatit **BESTAR ZEQIRI**.

21.12.2020

Tetovë

Lekturoi:

Prof. Fexhide Zeqiri
fexhidezeqiri12@gmail.com

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	3
Abstrakti.....	6
Abstract.....	7
Hyrje.....	8
Lënda e hulumtimit.....	10
Qëllimet e hulumtimit.....	10
Hipotezat.....	11
Hipoteza kryesore	11
Hipotezat ndihmëse	12
Metodologjia e hulumtimit.....	12
Rëndësia e punimit	13
KAPITULLI 1	15
Teoritë dhe metodat në funksion të qeverisjes së mirë përmes teknologjisë informative dhe planifikimet	15
Menaxhimi i udhëheqjes së procesve përmes teknologjisë informative në funksion të qeverisjes së mirë	15
Efikasiteti i qasjes ndaj resurseve dhe pikëpamjet e qëndrueshmërisë së e-qeverisjes	16
KAPITULLI 2	17
Menaxhimi i proceseve përmes teknologjisë informative për qeverisjen e mirë në sfera të ndryshme të sektorit publik në RMV	17
Kushtet themelore dhe kriteret për zhvillimin e qeverisjes dhe teknologjia informative.....	17
Teknologjia informative dhe qeverisja elektronike në mbështetje të sektorëve administrativ në RMV18	
Dizajni i reformave administrative përmes qeverisjes elektronike	19
Mundësitë e përdorimit të Teknologjisë informative si nevojë prioritare në sektorë të ndryshëm.....	20
Niveli i zhvillimit të Teknologjisë informative publike në administrimin publik	21
Qëndrimi i përgjithshëm ndaj TI-në administrimin publik.....	23
Potencialet e qeverisjes për zhvillimin e qëndrueshëm	24
Ndikimi në profilet e zhvillimit institucional	25

Ndikimi në profilet e zhvillimit social	26
Ndikimi në profilet e zhvillimit mjedisor	27
Ndikimi në profilet e zhvillimit ekonomik	28
Kufijtë e teknologjisë informative dhe të qeverisjes si faktorë për zhvillimin e qëndrueshëm	29
Bashkëpunimi me vendet në zhvillim për zgjerimin e teknologjisë informative dhe qeverisjes.....	32
Kriza e aftësisë urdhëruese e legjislativ dhe rolit të ri të mundshëm të burimit individual	33
Individi në organizatën e re administrative- autonomia, vlerësimi dhe përgjegjësia e menaxhimit	34
Mjedisi dhe ndikimi në aspekt ndërkombëtar në ekonomi: zhvillimi i qëndrueshëm	36
KAPITULLI 3	37
Paraqitja e rezultateve për teknologjinë informative në funksion të qeverisjes së mirë në RMV	37
Krijimi i strukturës së një programi hulumtues dhe specifikimi aktivitetëve.....	37
Përkufizimi i procesit në aspekt të implementimit.....	38
Programi hulumtues për specifikimin e aktivitetëve të teknologjisë informative në funksion të qeverisjes së mirë	38
Performanca dhe cilësia e qeverisjes përmes teknologjisë informative në nivel të përgjithësuar në RMV.....	39
Verifikimi – procesi i verifikimit të cilësisë dhe përshtatmëria për përdorim praktik	40
Elementet e vlerësimit të kualitetit dhe pikëpamjet menaxhuese për e-qeverisjen	40
Kualiteti, performanca, siguria si parametra kryesor në aplikimin e teknologjive moderne në administrimin publik	40
Lloje të gabimeve që mund të ndodhin në aplikacione dhe mundësia e korigjimit të gabimit	42
Vlerësimi i rrezikut dhe krahasimi me modelin relevant të verifikuar përmes rrugëve krahasuese në implementim.....	43
Metodat e përmirësimit të qëndrueshmërisë sistemore dhe ekonomike të strukturës së përzgjedhur	44
Procesi i sigurimit të sistemit përmes aplikimit të TI	44
Përcaktimi i kërkesave të kualitetit, porositë dhe mirëmbajtja	45
Integriteti i sistemit, siguria dhe kanosjet në sistemin e qeverisjes së mirë (e-qeverisja)	45
Zgjedhja e modelit të projektimit për modelin përkatës e funksional në administrimin publik	45
Standardet për sigurim të kualitetit që implementohen si të përgjithësuara në sisteme të ndryshme	46
Dokumentimi teknik në procesin e zyrtarizimit të sigurisë së punës me sportele në administrimin publik.....	46

Gjendja e procesit dhe qeverisja përmes TI.....	48
Pamje e qeverisjes së drejtëpërdrejt e sporteleve dhe pozicionet hapësinore	51
Pozicioni i optimizuar për shërbime adekuate dhe sistemi i teknologjive kompjuterike	51
Procesi i vlerësimit të aplikimit të teknologjisë informative për qeverisjen e mirë në RMV	54
KAPITULLI 4	56
Procesi i vlerësimit dhe implementimit të teknologjisë informative në funksion të qeverisjes së mirë në RMV.....	56
Krijimi dhe Menaxhimi i databazës për qeverisjen e mirë me Teknologjinë informative në RMV	61
Realizimi i objektivave kryesore të teknologjisë informative në një institucion përkatës me shërbime për shfrytëzuesit	61
Përfundim	67
Bibliografia	69

ABSTRAKTI

Në tezën e magistraturës është paraqitur procesi i implementimit të teknologjisë informative në funksion të qeverisjes së mirë në RMV. Fokusi i temës përqëndërohet edhe në aspekte komparative të zhvillimeve aktuale, dhe mundësia e inkorporimit të sistemeve më të sofistikuar në përputhje me platformat e reja. Për ta realizuar këtë, është analizuar puna e institucioneve të ndryshme, ndërmarrjeve të cilët kanë resurse për implementim. Për një qeverisje të mirë kërkohet edhe teknologji informative adekuate, e verifikuar dhe e validuar sipas standardeve relevante ndërkombëtare. Në tezën e masterit gjithashtu janë paraqitur rezultate konkrete përmes evaluimit me klientë të ndryshëm për të marrë të dhëna konkrete, të cilat pastaj paraqesin bazën funksionale të qeverisjes së mirë me mundësi modifikimi dhe përshtatje për platforma të ndryshme ose aplikacioneve përkatëse. Si pjesë tjetër karakteristike e tezës së masterit, është se gjatë prezantimit të rezultateve janë dhënë sisteme të ndryshme, ku janë analizuar dhe krahasuar karakteristikat e tyre; forma dhe modeli i implementimit. Duke patur parasysh të gjitha këto që kemi theksuar, pra është bërë një ndërlidhje e temave dhe proceseve me qëllim në fund të krijimit të një modeli, platforme të realizuar në aspekt të teknologjisë informative, e qëndrueshme dhe përshtatshme për realizim praktik. Poashtu në tezën e masterit është realizuar baza e të dhënave (aplikacion), që ndërlidh disa tabela, forma, pyetësor, raporte, në aspekt të realizimit të punëve dhe shërbimeve të ndryshme, për klientët, për ndërmarrjet, për qeverisjen në aspekt të përgjithshëm etj. Për qeverisje të mirë përmes sistemit të teknologjive informative, ose administrimit, në këtë rast është specifikuar pjesa në kuadër të organizimit dhe të planifikimit të punëve të ndryshme të institucioneve, si për shembull: ndërmarrjet publike ose private, institucionet bankare, telekomunikacionet, postat; aspekti i qeverisjes etj. Në punim është trajtuar aplikimi i teknologjive informative në funksion të qeverisjes së mirë në Republikën e Maqedonisë së Veriut; është realizuar analiza e zhvillimit të qëndrueshëm si një sistem i unifikuar dhe kompatibil në implementim.

Në aspekt të teknologjisë informative nënkuptohet vendosja dhe strukturimi, ndërlidhjeve komunikuese, pajisjeve tjera ndihmëse, të cilat përdoren në kuadër të e-qeverisjes. Menaxhimi i punëve administrative varet shumë nga platformat e TI, rrjetit komunikues. Për të gjithë këtë, për kryerjen e punëve në kohë sa më të përshtatshme dhe efektive merret në konsideratë: menaxhimi, kostoja –arsyeshmëria ekonomike, sociale dhe teknike etj.

ABSTRACT

In the master thesis is presented the process of implementation of information technology in function of good governance in RMV. The focus of the topic also focuses on comparative aspects of current developments, and the possibility of incorporating more sophisticated systems in line with the new platforms. To achieve this, the work of various institutions, enterprises that have resources for implementation is analyzed. Adequate governance also requires adequate information technology, verified and validated according to relevant international standards. The master thesis also presents concrete results through evaluation with different clients to obtain concrete data, which then represent the functional basis of good governance with the possibility of modification and adaptation for different platforms or relevant applications. As another characteristic part of the master thesis, is that during the presentation of the results different systems are given, where their characteristics are analyzed and compared; form and model of implementation. Having in mind all these that we have emphasized, a connection of topics and processes has been made in order to finally create a model, a platform realized in terms of information technology, sustainable and suitable for practical realization. Also in the master thesis is realized the database (application), which connects several tables, forms, query, reports, in terms of realization of various works and services, for clients, for enterprises, for governance in general aspect, etc. For good governance through the system of information technologies, or administration, in this case is specified the part within the organization and planning of various works of institutions, such as: public or private enterprises, banking institutions, telecommunications, post offices; aspect of governance etc. The thesis deals with the application of information technologies for the purpose of good governance in the Republic of Northern Macedonia; sustainable development analysis has been carried out as a unified and compatible system in implementation.

In terms of information technology is meant the establishment and structuring of communication interfaces, other assistive devices, which are used in the framework of e-government. The management of administrative affairs depends heavily on IT platforms, the communication network. For all this, for the performance of work in the most appropriate and effective time is taken into consideration: management, cost - economic, social and technical, etc.

HYRJE

Në tezën e magistraturës është realizuar specifikimi konkret i përfaqësimit të administrimit, përmes teknologjisë informative në funksion të qeverisjes së mirë në RMV (Republikën e Maqedonisë së Veriut). Për këtë është dashur që të realizohen një varg analizash, grumbullime informacionesh, në drejtim të nxjerrjes së rezonimeve konkrete në lidhje me gjendjen aktuale në RMV. Pasi janë bërë këto analiza, vazhdohet me principin e krahasimit të sistemeve të ndryshme në një kornizë më të gjerë, qoftë rajonale ose ndërkombëtare me qëllim, të vendosjes së një modeli bashkëkohor për çështje të e-qeverisjes sa më funksionale përmes teknologjisë informative. Për të vështuar dhe për të nxjerrë përfundime konkrete është e nevojshme krahasimi i punës së sistemeve të ndryshme, të cilët ofrojnë performancën e tyre. Por, gjithësesi si pikë referente është edhe aspekti i optimizimit të punës, duke përshkruar strukturën e modelit, në aspekt të administrimit, dhe menaxhimit të resurseve. Këto resurse mund të jenë kuadro të përgatitur-administrativ, dhe në anën tjetër platforma e teknologjisë informative me të gjitha elementet ndërlidhëse. Për të realizuar funksionalitetet e qeverisjes së mirë, kërkohet trajnimi i personelit, dhe vendosja e TI të përshtatshme me mundësi modifikimi dhe aplikimi. Të gjitha këto janë sfida në drejtim të vendosjes së strukturës adekuate, me qëndrueshmëri dhe arsyeshmëri ekonomike, sociale dhe teknike. Teza e masterit është ndarë në katër kapituj, ku trajtohen; Teoritë dhe metodat në funksion të qeverisjes së mirë përmes teknologjisë informative dhe planifikimet; Menaxhimi i proceseve përmes teknologjisë informative për qeverisjen e mirë në sfera të ndryshme të sektorit publik në RMV; Paraqitja e rezultateve për teknologjinë informative në funksion të qeverisjes së mirë në RMV; Procesi i vlerësimit dhe implementimit të teknologjisë informative në funksion të qeverisjes së mirë në RMV.

Në tezën e masterit është shfrytëzuar literatura aktuale për trendin aktual bashkëkohor në lidhje me ndërlidhjen e administrimit, të teknologjisë informative dhe qeverisjes si një funksion i nevojshëm për komunikimet bashkëkohore. Është realizuar edhe procesi i evaluimit të klientëve, institucioneve përmes platformës Google forms, prej ku nxirret rezultatet e evaluimit.

Janë krijuar tabela karahuese të sistemeve të ndryshme, me implementime të teknologjisë informative, nga ku është nxjerrë përfundimi se cilët sisteme janë më efikase, dhe si është performanca e tyre, siguria etj.

Është krijuar baza e të dhënave, dhe të dhënat janë vendosur në bazën e të dhënave, e krijuar enkas për tezën e masterit, dhe jep mundësi për ta ndërlidhur në nivel, lokal, komunal dhe shtetëror etj. Aplikacioni i realizuar - baza të dhënave na mundëson që të vendosim, tabelat, pyetësorët, format, raportet. Me këtë realizohet grumbullimi i të dhënave dhe paraqitja e tyre në një aplikacion të caktuar, i cili është i përshtatshëm për ta transferuar në lokacione të ndryshme dhe njëkohësisht me mundësi të modifikimit dhe përshtatjes. Është përdorur literatura e fundit e teknologjisë informative dhe funksionit të qeverisjes së mirë, të konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm në qeverisjen lokale-komunale, ose shtetërore. Poashtu, parashihet që personeli, administratorët etj, të jenë në gjendje të komunikojnë mes tyre dhe të këmbëjnë dokumente me anë të sistemit informativ. Fillimisht, trajtimi i procedurave relevante për krijimin e një funksioni të rregullt në aspekt të menaxhimit me të gjitha këto parametra të administrimit kërkon një sistem të qëndrueshëm, për menaxhimin e bazës së të dhënave dhe ofrimi i tyre për qëllime interne të institucionit ose të kompanisë e cila merret me menaxhim dhe përdorimin e këtyre resurseve.

LËNDA E HULUMTIMIT

Lëndë e hulumtimit është paraqitja e gjendjes momentale në administrimin publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke u bazuar në disa nga sferat e hulumtimit, të disa nga resurset e teknologjive moderne në administrimin publik, por edhe në sektorin privat. Hulumtimi nënkupton aspektin e gjetjes së gjendjes faktike, dhe konteksti tjetër është procesi i përshkrimit të kësaj gjendje, duke vendosur modele të sistemeve të cilët e përmirësojnë situatën e tillë, përmes modelimit, strukturimit dhe të instalimit të teknologjive të reja, ose modifikimit me pjesë alternative drejt përmirësimit të këtij shërbimi.

Në përgjithësi ky lloj modelimi nënkupton krijimin e hapësirës së rregullt të funksionimit normal të punëve në administrimin publik, duke përfshirë këtu: përcaktimin e burimeve teknologjike, vendosja edhe e sistemit përkatës, hapësirës kompjuterike, modelimi dhe sistemimi adekuat i pozicioneve prezantuese (mjeteve vizuale, projektorëve, sporteleve, kompjuterëve, sistemit të komunikimit etj) si dhe të sistemeve të menaxhimit të grumbullimit të dhënave; krijimi i arkivës specifike në kontekst të pikë grumbullimit të të dhënave të ndryshme në administrimin publik; me të cilën ballafaqohet administrimi publik në përgjithësi dhe aplikimi i teknologjisë informative në veçanti të implementuar.

Hulumtimi vazhdon mëtej në procesin e ndërlidhjes së kësaj strukture, platforme teknologjike me kërkesat e vet administratës në shërbim të vazhdueshëm me ndërmarrje; me kapacitete tjera administrative që ofrojnë shërbime për klient të ndryshëm, dhe deri në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të këtij sistemi, në një proces më të integruar dhe më të avancuar në aspekt të aplikimit. Paraqitja e hulumtimit, realizohet përmes proceseve komparative dhe në mënyrë vizuale paraqiten bllok skema të caktuara, që në mënyrë vizuale-reprezentative na ofrojnë funksionimin e rregullt në favorin e aplikimit të teknologjisë moderne në administrimin publik.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit është aplikimi i taknologjisë informative në funksion të qeverisjes së mirë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Administrimi i resurseve është pjesa më specifike në

kuadër të organizimit dhe të planifikimit të punëve të ndryshme të institucioneve relevante, si për shembull, institucionet bankare, ndërmarrje për shërbime komunikimi, postat, komunat dhe niveli qeveritar. Qëllimet e hulumtimit poashtu janë, trajtimi dhe analiza e zhvillimit të qëndrueshëm si dhe ndërlidhja me teknologjinë informative. Në aspekt të teknologjisë informative nënkuptohen vendosja dhe strukturimi i teknologjisë, ndërlidhjeve komunikuese, pajisjeve tjera ndihmëse, të cilat përdoren në kuadër qeverisjes (udhëheqjes). Pra, fokusi kryesor është si të krijojmë një sistem të tillë i cili do të mundësojë një punë adekuate për kryerjen e të gjithë aktiviteteve administrative me një menaxhim të mirë. Menaxhimi i punëve administrative varet shumë nga platformat teknologjike, nga qasjet e vet të punësuarve dhe të klientëve që shfrytëzojnë këto resurse. Procedurat administrative janë më fleksibël dhe të plotë, dhe lejojnë që një numër më i madh i kërkesave të menaxhohen ose të vlerësohen brenda kornizës së tyre, duke bërë të mundur që të merren në mënyrë sa më adekuate me bashkë-prezencën e nevojave ekonomike, sociale dhe mjedisore të cilat janë në themel të idesë së zhvillimit të qëndrueshëm. Prandaj, aspekti i aplikimit dhe menaxhimit kërkon ndërtimin e një sistemi të formatuar, me skemë të detajuar (me ndihmën e sistemit të skemave) me të gjitha kërkesat funksionale: hapësirës së punës, radhitja e personelit, që shërbehet me resurset për kryerjen e punëve në kohë sa më të përshtatshme dhe efektive. Për të realizuar këto qëllime si rast studimi do analizohen ndërmarrje me hapësirë dhe me shërbim më të gjerë në kuadër të shtetit.

HIPOTEZAT

Teza e magjistraturës do të trajtohet përmes hipotezës kryesore dhe hipotezave ndihmëse.

HIPOTEZA KRYESORE

- Teknologjia informative e pëmirëson punën, dhe kualitetin e shërbimit në funksion të qeverisjes së mirë në RMV (Republikën e Maqedonisë së Veriut).

HIPOTEZAT NDIHMËSE

- Gjendja faktike dhe struktura e teknologjisë informative dhe funksioni i qeverisjes së mirë. Modifikimi dhe përshtatshëmëria e resurseve administrative, sistemi i modelimit.
- Mundësia për gjetjen e mundësive dhe kapaciteteve të reja në aspekt të rritjes së shkallës së qëndrueshmërisë në funksion të qeverisjes së mirë-në administrimin publik ose privat dhe të ndërmarrjeve të ndryshme.
- Planifikimi për avancimin e strukturës-hapësirës së punës, për menaxhim më adekuat; përdorimi i pajisjeve përkatëse dhe nevoja për përcaktim të vlerësimit në përputhje me kërkesat e brendshme (të personelit) dhe përmbushjeve të kërkesave (të jashtme) përmes shërbimeve administrative për klient të ndryshëm që shfrytëzojnë këto shërbime.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në punimin e tezës së magjistraturës do të përdor disa metoda dhe teknika hulumtuese, të cilat janë të nevojshme dhe të domosdoshme për zbërthimin e temës. Ky hulumtim kërkon një qasje adekuate në mënyrë e vendosjes së procedurave të metodave hulumtuese, të cilët përcjellin kontinuitetin e zbrërthimit të problematikës së trajtuar dhe në arritjen e rezultateve relevante në aspekt të një hulumtimi të mirëfilltë. Si metodë karakteristike është:

- Metoda krahasuese
Metoda e krahasimit kryesisht do të implementohet në përcaktimin e modelit për krahasimin e disa nga aktivitetet për teknologjinë informative në funksion të qeverisjes së mirë në RMV-dhe në një adminstrim publik, dhe përzgjedhja e modelit më adekuat të shërbimit, përmes procesit të optimizimit të punëve dhe të performancës
- Metoda historike: qasja ndaj aktiviteteve zhvillimore të teknologjisë informative në funksion të qeverisjes së mirë dhe rrugëtimet drejt ngritjes së nivelit të shërbimit, rritjen e kualitetit.
- Aplikimi i metodave statistikore nënkupton, procesin e vlersimit përmes aplikimit të statistikave me kontekst karahasimin e rezultateve duke shfrytëzuar qoft shërbimin

klasik (vlerësimi përmes aspekteve statistikore, grafikoneve, vlerësimi përmes simulimit përmes aplikacioneve të ndryshme programore, softuerit simulativ etj).

- Analiza e një sistemi aktual, duke vendosur në fokus sistemin e krahasimit përmes evaluimit të sistemeve tjera dhe përzgjedhja e disa karakteristikave të cilën janë në favorin e përcaktimit të vlerësimeve progresive të sistemit aktual.
- Procesi i sintetizimit të të dhënave të ndryshme në një sistem më të integruar përmes principit të një induksioni përkatës, fillimisht të realizuar përmes analizave të caktuara.
- Intervista dhe anketimi

Procesi i intervistës përmes aplikimit të një simulimi dhe përmes rezultateve relevante, duke intervistuar punonjës, ndërmarrje dhe kompani të ndryshme që pasqyrojnë vlerësime për kualitetin e punës, sigurinë në punë në administrimin publik.

Gjithashtu përmes aspektit të anketimit përmbushet edhe procesi i intervistimit duke vendosur pika kyçe për trajtim, në një formë të një formulari “Pyetje-përgjigje” ose përzgjedhje, vlerësimi i punës së administrimit publik në funksion të qeverisjes së mirë, në aspekt të niveleve të kualitetit sipas shkallës së kualitetit, realizohet gjithashtu si një lidhje kthyesë edhe nga procesi i anketimit të ndërmarrjeve ose personelit kompetent në administrimin publik. Ky proces realizohet përmes platformës informatike duke krijuar forma adekuate të komunikimit përmes platformës së internetit etj.

RËNDËSIA E PUNIMIT

Punimi ka rëndësi të veçantë, sepse duke përdorur këtë model të hulumtimit, arrihet krijimi i një modeli të përshtatshëm për menaxhim të suksesshëm të teknologjisë informative në funksion të qeverisjes së mirë në RMV, administrimin publik, dhe në të gjitha sferat e saj.

Ky punim, ofron edhe modelin e paraqitjes së sistemit relevant përmes përshkrimit, dokumentimit, dhe paraqitjes së platformës adekuate për përdorim praktik. Punimi, ndikon drejtpërdrejt në avancimin e pamjes së administratës publike, e nxjerr nga situatat problematike

kur kjo pjesë përballlet me shërbimet që u ofrohen klientëve, shërbime ndaj kompanive, ose me gjerë në kuadër të shtetit etj.

Implementimi teknologjive informative aktualisht është e domosdoshme për funksionim normal të shumë ndërmarrjeve publike dhe private, komunave, dhe qeverisë etj.

Në punim jepen variante të verifikuara për modifikim të aspektit hapësinor dhe pjesës tjetër të administratës, që lidhet me spektrin e gjerë të shërbimeve ndaj konsumatorëve të ndryshëm. Në punim ofrohet procesi i modifikimit të teknologjisë informative në funksion të qeverisjes së mirë, si mënyrë e nevojshme drejt zhvillimit dhe avancimit të punëve që zhvillohen kudo ku kjo qeverisje funksionon.

Pra, gjithashtu rëndësia e punimit është se merr si shembuj në formë komparacioni ndërmarrje etj. Në punim theksohet roli relevant i kualitetit të shërbimit si një standard i nevojshëm, madje edhe i domosdoshëm shtetëror dhe ndërkombëtar drejt krijimit të platformave të mira ndërkombëtarisht të shfrytëzueshme dhe të aplikueshme etj.

Poashtu pjesë e punimit janë edhe simulimet përmes aplikacioneve softuerike, që zgjerojnë pikëpamjen e përdorimit praktik të këtij punimi.

Punimi ndërlidh mjaft mirë aspektin teorik me atë praktikë, dhe kjo jep performancën kryesore në drejtim të implementimit të këtyre rezultateteve në ndërmarrje ose vende tjera që përkrahin dhe zhvillojnë funksionimin e këtij strukturimi të përshtatshëm për teknologjinë informative dhe qeverisjen e mirë.

KAPITULLI 1

TEORITË DHE METODAT NË FUNKSION TË QEVERISJES SË MIRË PËRMES TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE PLANIFIKIMET

- Teoritë, planifikimi strategjik dhe përgjegjësitë në shërbimin publik
- Punime shkencore ndërkombëtare për qeverisjen përmes teknologjisë informative
- Planifikimi dhe procesi i modelimit dhe dizajnit të sistemit në administrimin publik

MENAXHIMI I UDHËHEQJES SË PROCESVE PËRMES TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË FUNKSION TË QEVERISJES SË MIRË

Në fushën e menaxhimit përmes teknologjisë informative në funksion të qeverisjes së mirë në RMV, janë konceptuar praktikat reja në aspekt të integritit dhe veprimit dhe të inkuorporimit të shqetësimeve mjedisore përmes procesit të qëndrueshmërisë së sistemit dhe përshtatshmërisë në struktura të reja. Për shembull, një numër i posaçëm i veçantë ofron disa njohuri të rëndësishme në menaxhimin e resurseve kompjuterike, qeverisjen dhe rregullativat (standardet). Synimi i punimit është krijimi i një sistemi integruar dhe ndërveprues me sisteme tjera. Ky integrim është një proces i unifikimit të platformave dhe sistemeve të ndryshme në një sistem më të avancuar dhe të përshtatshëm. Kur themi të përshtatshëm nënkuptojmë, mundësinë e modifikimit në kohë reale, dhe sistemimi i të dhënave në një bazë e të dhënave në funksion të qeverisjes së mirë. Duke shikuar në këtë aspekt, rezulton se qëllimi i punimit, është skenimi gjendjes aktuale, dhe mundësia për vendosjen e një sistemi më të përshtatshëm në aspekt funksional qeverisës dhe me platformë e cila mbështet lloje të ndryshme të proceseve

dhe siguron mbrojtjen e të dhënave. Në vendet ku problemet me sistemet kompjuterike janë të shprehura, atëherë ekziston mundësia që të kemi devijim të proceseve të menaxhimit dhe në fakt edhe të ndërprerjes së punës në faza të ndryshme. Prandaj, fillimisht mendohet strukturimi, evaulimi, pastaj vendosja e pajisjeve adekuate që kanë rol kyç, në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e qeverisjes me të gjitha aktivitetet. Kjo sigurisht kërkon procesin e evaulimit, dhe krijimin e sistemit i cili ofron mundësi të verifikimit dhe validimit të të specifikacioneve përkatëse në lidhje me procesin e dhënë

EFIKASITETI I QASJES NDAJ RESURSEVE DHE PIKËPAMJET E QËNDRUESHMËRISË SË E-QEVERISJES

Zhvillimi i qëndrueshmërisë po merr vëmendje më të madhe në teorinë dhe praktikën e qeverisjes përmes teknologjive informative. Në këtë rast duhet të merret në konsiderat efikasiteti, dhe se kjo pikëpamje ndikon në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve dhe të vet administruesve të këtij sistemi.

- A mundet që parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të promovojnë hapa të sigurtë në menaxhimin e sistemeve?
- A do të jenë në kundërshtim dhe ky modifikim me aktualitetet në vende tjera?
- Cilat janë rrjedhojat nëse ky sistem është i qëndrueshëm dhe aplikativ?

Teza e masterit, i konsideron këto pyetje duke eksploruar studime të rasteve në të cilat aplikimi dhe praktika e qëndrueshmërisë është e integruar dhe ofron shembuj konkret të implementimit të këtyre funksioneve qeverisëse në favorin e mirë të procesi të përgjithshëm. Këtu diskutohet edhe roli i zhvillimit të qëndrueshëm në menaxhim, të rrezikut, të standardeve dhe në promovimin e përdorimit të qasjeve të sistemeve, njohurive për kohën dhe vendin dhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara në drejtim të favorizimit konkret të këtij sistemi.

KAPITULLI 2

MENAXHIMI I PROCESEVE PËRMES TEKNOLOGJISË INFORMATIVE PËR QEVERISJEN E MIRË NË SFERA TË NDRYSHME TË SEKTORIT PUBLIK NË RMV

- Menaxhimi i sistemeve të teknologjisë informative në agjencitë, ndërmarrjet e sektorit publik
- Hulumtimi i shërbimeve të teknologjive moderne në administrimin publik
- Procesi i modelimit dhe simulimit në ndërmarrjet në zhvillim përmes softuerit aplikativ
 - Optimizimi i punës së qeverisjes organizative dhe aplikimi i TI
 - Siguria dhe privatësia e punës për qeverisje funksionale

KUSHTET THEMELORE DHE KRITERET PËR ZHVILLIMIN E QEVERISJES DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Një rëndësi e veçantë në trajtimin e temës së futjes së teknologjisë informative në administrimin publik është të supozojmë se çështja zgjidhet me futjen e teknologjive të reja informatike dhe procedurave automatike për përpunimin e të dhënave në mbështetje të veprimtarisë së zyrave, të cilat në vetvete ndikon mjaftueshëm për të përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin e punës në administratave publike. Përvoja e fituar me zhvillimin e teknologjive informative publike ka treguar se çështja nuk është aq e thjeshtë. E para është mungesa e korrespondencës midis "anës administrative" tradicionale dhe "teknologjisë informative". Një lidhje e teknologjisë informative në fakt kërkon një organizim në formën e një rrjeti, modeli operativ të marrëdhënies dhe ndërveprimit dhe një prirje të theksuar për këmbimin e informacionit. Në vend të kësaj, kjo karakterizohet nga struktura piramidale me integrim të lartë vertikal në një kuptim hierarkik; nga një model procedural sekuencial, i konceptuar si një

"seri veprimesh" për prodhimin e të cilave kontribuojnë në mbledhjen e informacionit, grumbullimit, dhe pastaj shpërndarjen sipas kërkesave.

Çështja tjetër është planifikimi në fushën e teknologjisë informative për funksionimin e qeverisjes (udhëheqjes) në fazën fillestare të procedimit të të dhënave deri në atë përfundimtare. Shkaku i gjithë kësaj është të gjenden mundësitë më të mira të planifikimit, planifikimit të standardizuar konform algoritmeve përkatëse që autonom dhe në nevojën e duhur për të kërkuar ndihmë nga jashtë për planifikimin e sistemeve automatike të informacionit.

Nga ana tjetër, kjo nevojë ka prodhuar kosto të larta dhe vështirësi të konsiderueshme në lidhjen e sistemeve të ndryshme të informacionit të kompjuterizuar.

Problemi i tretë dhe i fundit është mënyra reduktuese në të cilën janë parë potencialet e teknologjisë informative. Futja e teknologjisë informative në administrimin publik në përgjithësi ka qenë e kufizuar në riprodhimin e procedurës burokratike ekzistuese, në bindjen se procedurat e teknologjisë informative do të ishin riprodhimi i thjeshtë përmes teknologjisë informative të procedurave tradicionale administrative, shoqëruar nga frika se çdo largim nga rutina do të kishte ekspozuar gabime zyrtare të kryera gjatë veprimtarisë administrative.

TEKNOLOGJIA INFORMATIVE DHE QEVERISJA ELEKTRONIKE NË MBËSHTETJE TË SEKTORËVE ADMINISTRATIV NË RMV

Pasi të keni sqaruar kushtet themelore për zhvillimin e teknologjisë informative publike dhe qeverisë-elektronike, hapi tjetër është të verifikoni nëse këto kushte janë të pranishme në administrimin publik dhe, nëse po, në çfarë shkalle.

Një verifikim i tillë është i nevojshëm për të kuptuar se cilat janë supozimet, nëse ka, për përdorimin efektiv të Teknologjisë informative dhe teknikave të qeverisjes elektronike si mjete për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe për konkurrencën.

DIZAJNI I REFORMAVE ADMINISTRATIVE PËRMES QEVERISJES ELEKTRONIKE

Mundësitë e një përdorimi të dobishëm të teknologjisë informative publike dhe të qeverisjes elektronike varen para së gjithash nga prania e një modeli të përgjithshëm për zhvillimin e teknologjisë informative publike dhe përfshirjen e të njëjtit brenda një konteksti më të gjerë të administratës. Në kohën e tanishme, mund të thuhet se kjo gjendje është sjellë në disa vende, të paktën në planin normativ.

Reforma e administrimit publik është një proces që ka filluar për më shumë se një dekadë, dhe i cili u vu në lëvizje falë një kornize koherente të veprimit legjislativ që fillon me ligjet e reformës së vitit 1990 në lidhje me autonominë lokale dhe procedurat administrative; këto kanë ndikuar si në organizimin ashtu edhe në veprimtarinë e administrimit publik, me qëllim të krijimit të një administrate publike të një cilësie më të lartë në krahasim me të kaluarën, domethënë më efikase, më të thjeshtë, më pak të kushtueshme, më transparente, më pak autoritare, më të hapur për pjesëmarrje të qytetarëve individualë dhe më shumë të bindur për plotësimin e nevojave të tyre, më pak të fshehtë përsa i përket kompetencave formale dhe të aftë për një integrim më të madh horizontal, të gjithë sipas një logjike të bashkëpunimit tërthor në lidhje me kompetencat tradicionale, në funksion të rezultateve më të kënaqshme që priten, në ndjekje të mirëqenies së përgjithshme.

Me këtë model për reformë, për të gjitha vështirësitë e ndryshme në realizimin e saj, administrata ka filluar të shfaq imazhin e saj tradicional të administratës/autoriteteve, e cila e vendosi atë në një nivel të superordinuar për publikun e gjerë dhe të ndarë nga qytetarët e zakonshëm, legjitimoi vetëm si një ekzekutues i normave.

Nocioni i një administrimi publik "të orientuar nga qytetarët" gradualisht po kërkon pikëpamjen se: administrimi publik funksionon me pjesëmarrjen e qytetarit në veprimtarinë administrative; rregullohet sipas parimeve të publicitetit, ekonomisë, efektivitetit, efikasitetit dhe thjeshtësisë; dhe legjitimohet jo vetëm nga respektimi i normave, por para së gjithash nga cilësia e shërbimeve të kryera dhe nga rezultatet e arritura.

Prandaj, janë përmbushur të gjitha parakushtet në mënyrë që administrimi publik të zhvillohet në drejtim të një cilësie më të lartë, e cila do t'i lejojë asaj të funksionojë në një mënyrë të

konsiderueshme në favor të zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë kuptim, atëherë futja e teknologjisë informative (teknologjisë informative publike) dhe e-qeveria nuk paraqiten si qëllime të vetëpërmbytura, por përkundrazi supozojmë vlerën e instrumenteve për përmbushjen e formës së administrimit publik, si dhe rriten në të njëjtën kohë me vendosmërinë për të siguruar që shndërrimet në zhvillim në administratë japin rezultate konkrete.

Në funksion të lidhjes së ngushtë me reformën administrative që po zhvillohet për disa vite, mund të pohohet se realizohen zhvillime maksimale në aspekt të konsolidimit të resurseve teknike, ekonomike dhe pajisjeve adekuate për menaxhim të suksesshëm të funksionimit të qeverisjes së mirë.

Kuadri normativ në çështjen e teknologjisë informative publike siç u përmend më parë, dhe se aktualisht korniza normative që rregullon informatikën publike është mjaft e plotë dhe koherente. Pas një faze fillestare kur futja e Teknologjisë informative në administrimin publik u ndihmua dhe u zhvillua kur filluan të ndërmerren hapa korrigjues, në fillim të një natyre sporadike, dhe pastaj gjithnjë e më organike dhe koherente. Masat e tilla u morën që nga fundi i viteve 1980 dhe ky realizim ka vazhduar dhe vazhdon dhe aktualisht në drejtim të rritjes së optimizimit të punës, koherencës, dhe përshtatjes me platforma të reja në nivel të konsiderueshëm përmes teknologjisë informative.

MUNDËSITË E PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE SI NEVOJË PRIORITARE NË SEKTORË TË NDRYSHËM

Korniza evolucionare e përshkruar më sipër shërben për të treguar se si një klimë e favorshme ekziston aktualisht në planin normativ për futjen e teknologjisë informative publike dhe qeverisë elektronike në administratat publike. Në veçanti, një ndërlidhje gjithnjë e më e madhe midis administratave publike sigurohet përmes përdorimit të sistemeve të teknologjisë informative.

Qëllimi i synuar nuk është vetëm të lehtësojë komunikimin më intensiv të brendshëm dhe të jashtëm, por edhe të arrihet një nivel më i kënaqshëm i integritetit ndërmjet dhe midis

artikulacioneve të ndryshme organizative, me perspektivën që kjo mund të çojë në konsiderimin e administratave territoriale fizikisht më të afërt me një të dhënë popullsia si terminale të zyrave të përparme, duke përfshirë administratat e tjera më të largëta nga vendi ku konsumatorët e çfarëdo shërbimi publik çojnë zakonisht jetën e tyre.

Përgjatë të njëjtës linjë, parashikohet që përveç që të jenë në gjendje të komunikojnë mes tyre dhe të shkëmbejnë dokumente me anë të sistemit informatik, administratat publike mund të përcaktojnë marrëveshje oportune duke u dhënë administratave të tjera të drejtën e qasjes në regjistrat e tyre informatikë, duke vendosur kështu terren për kalimin nga një administratë territoriale e integruar vertikalisht në një administratë të delokalizuar të integruar horizontalisht.

Për këtë qëllim, një zvogëlim drastik po zhvillohet në rëndësinë që i atribuohet profileve tradicionale të legjitimitetit zyrtar të veprimtarisë administrative, të cilat deri më tani kanë përbërë gjithmonë një pengesë për një shkëmbim më të shpejtë të të dhënave dhe informacioneve të tjera midis administratave të ndryshme publike. Fakti i dukshëm në këtë drejtim është njohja e vlefshmërisë së plotë për qëllime ligjore të dokumenteve informatikë, e cila i hap rrugën të ashtuquajturës "administrim pa letër", ku sistemet automatike të informacionit mund të përdoren në të gjitha fazat e ndryshme të procedurave administrative, përfshirë fazën e vendimmarrjes, në mënyrë që avantazhet që sisteme të tilla të ofrojnë për sa i përket shpejtësisë dhe sasisë së të dhënave të transmetuara nuk zvogëlohet nga detyrimi që produkti përfundimtar të jetë në letër.

NIVELI I ZHVILLIMIT TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE PUBLIKE NË ADMINISTRIMIN PUBLIK

Sidoqoftë, nuk duhet të mashtrohemi nga fakti se ekziston një kornizë normative e cila është e favorshme për zhvillimin e teknologjisë informative publike dhe qeverisë elektronike duke menduar se ato tashmë janë një realitet në administratat e ndryshme publike. E vërteta e çështjes është se çështja e zbatimit efektiv të normave është ende e hapur, me atë që shpesh është e ngadaltë dhe e paplotë për shkak të pamjaftueshmërisë së infrastrukturës së nevojshme teknologjike dhe të vonesave në rrënjën e një kulture administrative të favorshme për përdorimin e tyre dhe në identifikimin pasues brenda administratave të aftësive të

nevojshme për përdorimin, planifikimin dhe azhurnimin e vazhdueshëm të sistemeve automatike të informacionit.

Prandaj, duhet të vërehet se sot, përkundër hapave që po ndërmarrin në drejtimin e duhur, shumë administrimi publik ekzistojnë akoma me një nivel të papërshtatshëm të zhvillimit teknologjik, ku pajisjet e pajisjeve kompjuterike dhe softverike janë të pranishme, por jo gjithmonë të azhurnuara dhe, më së shumti më e rëndësishmja, jo gjithnjë e shfrytëzuar për në grumbull.

Për më tepër, niveli efektiv i zhvillimit të integritit të rrjetit në mes të administratave është edhe më i ulët, jo aq thjesht sa i përket qasjes në internet, e cila tani është mjaft e zakonshme, aq sa për sa i përket krijimit të rrjeteve në gjendje për të sjellë integrimin horizontal të administratave të ndryshme publike.

Kjo situatë varet shumë nga këmbëngulja e një kulture administrative e mbizotëruar nga logjika e një ndarje të qartë të artikulacioneve të ndryshme organizative, nga e cila rrjedh një nivel i ulët i integritit dhe zakoni i administrimit të informacionit në një mënyrë shumë të larguar nga komunikimi i ndërsjellë. Kjo ka prodhuar mungesë brenda administratave publike të një ndjeshmërie specifike përballë mundësive për integrim organizativ të ofruar nga teknologjia informative dhe, për rrjedhojë, vëmendje të vogël në zhvillimin e tij në atë kuptim.

Në fund, përgjegjësia për verifikimin e efektivitetit praktik të strukturave të teknologjisë informative me të cilat janë të pajisura zyrat dhe për të tërhequr vëmendjen për të metat eventuale, si dhe për sigurimin e efikasitetit të modaliteteve për efektin e komunikimeve të nevojshme për kryerjen e çfarëdo procesi administrativ, dhe për këtë arsye për marrjen ose transferimin e informacionit përkatës, caktohet nga rregullat dhe rregulloret në figura specifike organizative, siç është personi përgjegjës për çfarëdo procedimi administrativ dhe zyrat për marrëdhënie me publikun.

QËNDRIMI I PËRGJITHSHËM NDAJ TI-NË ADMINISTRIMIN PUBLIK

Shembull: Në vijim do të caktojmë performancën e disa lokacioneve administrative të vendosura në pozicione të ndryshme gjeografike. Vlerësimi i performancës së sistemit është një mundësi e mirë, për të vlerësuar se sa efikas do të jetë, lokacioni administrativ, në kuptim të resurseve të teknologjisë moderne (pajisje të komunikimit, pajisje kompjuterike, pajisje ndihmëse për zyrën e administrimit publik, kërkesat për ambient të përshtatshëm të punës, si dhe kërkesa të tjera që lidhet qoft me sportelin, qoft me një zyrë që menaxhon me shërbime të çfarëdo qoft me klientët që shfrytëzojnë këto shërbime).

Sistemi (koha në orë-h)	Lokacioni i qeverisjes përmes TI -1	Lokacioni i qeverisjes përmes TI -2	Lokacioni i qeverisjes përmes TI -3	Lokacioni i qeverisjes përmes TI -4	...
Sistemi1: teknologjia, hapësira, resurset etj.	1.8	2	3.2	3.1	...
Sistemi2: teknologjia, hapësira, resurset etj.	2.2	1.9	2.6	2.7	...
Sistemi3: teknologjia, hapësira, resurset etj.	2.6	2.8	3.1	3.2	...
Sistemi4: teknologjia, hapësira, resurset etj.	2.4	2.5	2.9	3.3	...
Totali i kohës për menaxhim	2.25	2.3	2.95	3.075	..
...	...	...	...	...	...

Tabela 3.1.Performanca e disa Lokacioni i qeverisjes përmes TI -sipas sistemeve

Performancë më të mirë ka “Lokacioni i qeverisjes përmes TI 1”, sepse të gjitha aktivitetet e sistemeve 1, 2,3,4, në totalitet, i kryejnë punët për kohë më të shpejt (për 2.25 orë). Ndërsa, **performancë më të ultë ka në “Lokacioni i qeverisjes përmes TI -4”**-sepse kohëzgjatja për kryerjen e punëve është më e gjatë, si totalitet i kryerjes së punëve në të gjitha sistemet 1,2,3,4 etj,



Grafiku.3.1-Grafikoni për performancën e Lokacioni i qeverisjes përmes TI -sipas sistemeve përkatëse

Përfundimi i aplikacioneve dhe implementimi

Zhvillimi dhe projektimi i softuerit duhet të siguroj kualitetin e kërkuar, ashtu që gjatë verifikimit mund që eventualisht me rrezik minimal të vërtetohet se softueri i përmbush kërkesat, me çka vërtetohet se është i disponueshëm nën kushte dhe në kohë të caktuar. Këtu flitet për shkallën e sigurisë të softuerit.

LLOJE TË GABIMEVE QË MUND TË NDODHIN NË APLIKACIONE DHE MUNDËSIA E KORIGJIMIT TË GABIMIT

Në varësi të llojit, vëllimit dhe mënyrës së funksionimit të softuerit, paraqiten disa lloje të gabimeve. Sipas mënyrës së gabimeve mund të jenë:

- Aritmetike
- Logjike
- Sintaksore dhe semantike
- Gabimet në transmetim të të dhënave

Për shkak të natyrës së gabimeve, realizohet analiza në zbulimin e gabimeve dhe analiza për gjetjen e shkakut të gabimeve. Këtu parashtrohet pyetja, a janë gabimet e qëllimshme ose të paqëllimshme? Nëse janë të paqëllimshme, zakonisht bëhet fjalë për gabime të ashpra dhe në të shumtën e rasteve zbulohen në procesin e debugimit (debugging). Për të zbuluar gabimet e qëllimshme duhet përvojë më e madhe.

Disa gabime kanë pamjen e gabimeve të paqëllimshme dhe nuk zbulohen deri në momentin kritik, pas zbulimit kategorizohen sipas natyrës së gabimit. Megjithatë, ekzistojnë edhe gabime të paqëllimshme që qëndrojnë dhe nuk zbulohen deri në momentin kritik, madje edhe në fazën e eksploatacionit. Ky lloj gabimi zakonisht ka të bëjë me gabimet aritmetike, të cilët manifestohen kur bëhet kombinimi i papërshtatshëm i argumenteve dhe atëherë vinë deri te operacionet matematikore të pa zbërthyera, pa mekanizmin përkatës mbrojtës (manipulimi me sfida, “watchdog timer”), ku sistemi IT dështon.

Gabimet sipas rregullës zbulohen në fazën e hulumtimit me të ashtuquajturën vërtetim i korrektësisë së programit, por për zbulim të gabimeve të qëllimshme, programuesit i duhet kujdes i veçantë dhe përdorim të teknikave analitike.

VLERËSIMI I RREZIKUT DHE KRAHASIMI ME MODELIN RELEVANT TË VERIFIKUAR PËRMES RRUGËVE KRAHASUESE NË IMPLEMENTIM

Verifikimi përfshinë procesin e detajuar të testimit që realizohet me dëshminë e korrektësisë, zbërthimin e testit të zgjedhur me qëllim të zbulimit të të gjitha kategorive të gabimeve në softuer, në fazën e fundit të zhvillimit dhe projektimit, para se të lëshohet në eksploatim.

Për pasojat e manifestimit të gabimeve në eksploatim, shumica e tyre janë bashkësi të hulumtimeve të gjera gjatë zhvillimit dhe projektimit. “Zbulimi” i gabimeve në eksploatim mund të shkakëtoj dëme, humbje në zbatime të caktuara, madje edhe pasoja tragjike. Kompleksiteti dhe “abstraktiviteti” i softuerit e bën verifikimin punë të mundimshme. Ekziston, nevoja e verifikimit në nivel të çdo linje të programit, në nivel të instruksionit, që të shmangët paraqitja e

gabimit në çfarëdo gjendje të softuerit. Hulumtimi i detajuar mundëson vlerësimin e paraqitjes së gjasës së gabimit (f). Madhësia për matjen e rrezikut të vlerësuar (r), paraqet prodhimin e vlerësimit të paraqitjes së gjasës së gabimit (f), si dhe të madhësisë të dëmit eventual (g):

$$r = f * g.$$

METODAT E PËRMIRËSIMIT TË QËNDRUESHMËRISË SISTEMORE DHE EKONOMIKE TË STRUKTURËS SË PËRZGJEDHUR

Praktika ka treguar, që sistemi duhet të jetë:

- Me kualitet të lartë,
- Nivel i lartë i sigurisë së aplikimit,
- Zvogëlimi i rrezikut deri në nivel të pranueshëm,

Pë tu arritur pikat e theksuara duhet ndërmarrë masa organizative për parandalimin e gabimeve, ndalimin e keqpërdorimit dhe zbulimin e tyre në të gjitha fazat e zhvillimit dhe projektimit. Këto masa janë shënuar me standarde për “siguri të kualitetit të sistemit”. Në varësi të destinimit të aplikimit të softuerit, ka standarde përkatëse që bazohet në teknologjinë e projektimit.

PROCESI I SIGURIMIT TË SISTEMIT PËRMES APLIKIMIT TË TI

Procesi i sigurimit të softuerit kualitativ nënkupton metodologjinë e qartë dhe të pranueshme të zhvillimit dhe projektimit në përputhje me specifikimin e kërkesave të përgjithshme të kualitetit dhe marrëveshjeve. Ky proces realizohet me aktivitete të planifikuara, sipas principeve dhe rregullave të projektimit të modelit.

Verifikimi dhe pranimi teknik është faza e fundit e projektimit, para aplikimit të eksplotimit. Në mënyrë metodologjike paraqet zhvillimin e duhur dhe projektimin për realizimin e kërkesave të softuerit që realizohet sipas fazave vijuese:

- Përcaktimi (specifikimi) i projektimit të kërkesave të kualitetit
- Marrëveshja (negocimi)
- Projektimi
- Hulumtimi dhe pranimi
- Eksplotimi dhe mirëmbajtja

PËRCAKTIMI I KËRKESAVE TË KUALITETIT, POROSIA DHE MIRËMBAJTJA

Gjatë përcaktimit të kërkesave që kontraktohen për softuerin, më kryesore janë tre aspekte, që janë përcaktuar me standardet vijuese:

- Kualiteti (standardi ISO/EC 9126-1996).
- Performansa (standardi ISO/IEC14756-1999).
- Siguria-seria e standardeve ISO/IEC.

Standardet për kualitet të softuerit kanë të përcaktuar atributet e softuerit siç janë: funksionaliteti, ndërveprimi, transmetimi, siguria etj.

INTEGRITETI I SISTEMIT, SIGURIA DHE KANOSJET NË SISTEMIN E QEVERISJES SË MIRË (E-QEVERISJA)

Integriteti i sistemit është karakteristika më e rëndësishme në ruajtjen e tërësisë së sistemit dhe softuerit në platforma të ndryshme të operimit.

$$Integriteti = \sum_{i=1}^n [(1 - \text{Kanosjet}_i) \cdot \text{Siguria}_i]$$

- Integriteti (Integrity)
- Kanosja, kërcënim (Threat)
- Siguria (Security).

Integriteti është masa e aftësisë së sistemit për të parandaluar kërcënimin në sigurinë e tij.

ZGJEDHJA E MODELIT TË PROJEKTIMIT PËR MODELIN PËRKATËS E FUNKSIONAL NË ADMINISTRIMIN PUBLIK

Me negocim (bisedim, me marrëveshje) përveç kërkesës së kualitetit, performancës dhe sigurisë, duhet përkufizuar edhe modeli i projektimit, që varet nga lloji i softuerit që zhvillohet.

Është me rëndësi zgjedhja e modelit, nëse kompleksiteti i softuerit kërkon hulumtim pranues të gjerë, ose është i dedikuar për natyra të ndjeshme (financiare, informuese, mbrojtëse) për krijimin e kushteve për pjesëmarrje të shfrytëzuesit në të gjitha fazat e projektimit.

STANDARDET PËR SIGURIM TË KUALITETIT QË IMPLEMENTOHEN SI TË PËRGJITHËSUARA NË SISTEME TË NDRYSHME

Zgjedhja e modelit të udhëheqjes me projekte është e përcaktuar me standardet për sigurim të kualitetit. Njëri nga standardet e para që janë shënuar për sigurim të kualitetit të softuerit në zhvillim të projektimit janë MIL-S-52779 A dhe DOD-STD-2157.

Këto standarde që ndërlidhen me teknologjinë siguroese, për përdorim civil gjatë kohë nuk kanë qenë standarde adekuate që do ti përshkruanin kushtet e kualitetit, kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për softuerin dhe destinimet e ndryshme.

Nga viti 1995 janë përvetësuar standardet ISO/IEC që në mënyrë të detajuar rregullojnë udhëheqjen me projektet për sigurim të kualitetit të softuerit. Rëndësi themelore në projektim të softuerit ka standardi ISO/IEC/IEEE 12207-1995. Siguria e sistemeve informuese dhe softuerit është rregulluar me standarde të veçanta. Në këtë sferë kryesisht përdoren standardet ISO/IEC nga seria TR 13335, ISO/IEC 15408 dhe ISO/IEC 900-3.

DOKUMENTIMI TEKNIK NË PROCESIN E ZYRTARIZIMIT TË SIGURISË SË PUNËS ME SPORTELE NË ADMINISTRIMIN PUBLIK

Një aspekt i rëndësishëm i sigurimit të kualitetit të softuerit është definimi i mirë i negocimit të blerësit dhe krijuesit të softuerit në kuptim të dokumentimit teknik. Përveç kërkesave të mëparëshme dhe kushtet, një aspekt i rëndësishëm është kompletimi i dokumentacionit teknik të softuerit, i cili duhet të siguroj kushte për verifikimin dhe mirëmbajtjen e softuerit. Standardet që rregullojnë kualitetin e dokumentimit të softuerit janë ISO/IEC 9127, ASTM E919-96 etj.

Me këto standarde nënkuptohet kompletimi i dokumentacionit në të gjitha nivelet e sistemit programor. Kjo nënkupton përshkrimin e të gjitha detyrave programore, punët dhe proceset. Me këtë programuesit, detyrohen të jenë të hapur, të mbrojnë dhe të pengojnë që në zgjidhjet programore të futen “inovacione” të paautorizuara.

Kushtet teknike, siç janë principet e komunikimit (“top-down”, modulariteti), principet e programimit (orientuar në objekte, të strukturuar), përzgjedhja e gjuhës programore, janë gjithashtu të rëndësishme për sigurim të kualitetit të softuerit.

Projektimi i sistemit për qeverisjen e mirë me teknologjinë informative dhe principet kryesore

Projektimi realizohet sipas principeve të sistemeve të modelimt në fazat si në vijim:

- Analiza e kërkesës së sistemit
- Përkufizimi i kërkesave të sistemit
- Projektimi preliminar
- Projektimi i detajuar
- Kodimi dhe testimi i modulit
- Integrimi i komponenteve dhe testimi
- Integrimi dhe testimi i nënsistemeve
- Integrimi i sistemit dhe testimi

Pa marrë parasysh në zbatimin e pajisjeve të automatizuara për programim dhe testim, në të gjitha fazat e projektimit ekziston mundësia për paraqitjen e gabimeve në softuer. Për këtë ekziston nevoja për testim të detajuar dhe hulumtime.




Fig. 3.2 - Modeli karakteristike për zhvillimin e modelit të projektit dhe fazat e projektimit

GJENDJA E PROCESIT DHE QEVERISJA PËRMES TI

Proceset ndodhen në një nga këto gjendje:

- Procesi ekzekutohet (unning): procesori faktikisht ekzekuton kodin e këtij procesi. (punëtorët në administratën përkatëse janë në vendin e punës.
- Procesi është gatshëm, por nuk ekzekutohet (Ready): procesi ka fituar të gjitha resurset e nevojshme dhe është i gatshëm për ekzekutim dhe pret-për të realizuar aktivitetet e punës përmes sistemit të teknologjisë moderne/ Aplikacioni dhe sistemi i gatshëm.
- Procesi është i bllokuar, pret diçka (për shembull, gadishmërinë e punëtorëve në sportele të përfundoj me përgatitjen e sistemit kompjuterik-Blocked): për punë të mëtejshme të procesit janë të nevojshme disa resurse, të cilat momentalisht nuk janë në dispozicion, pret operacionet hyrje-dalje (IO), rezultatin e ndonjë procesi tjetër etj.




Fig. 3.3 Gjendja e procesit në sportele të administrimit publik ku aplikohet teknologjia informative

Ekzistojnë 4 kalime ndërmjet gjendjeve të ndryshme:

1. Procesi kalon nga gjendja e “Ekzekutimit” në gjendjen e “Bllokimit”, ku për ekzekutim vijues ka nevojë për disa resurse, që momentalisht nuk kanë qasje. Këtë ndërrim të gjendjes e kryen vet procesi; bën kërkesën për ndonjë resurs dhe e pret atë resurs. Për shembull, punëtorët janë të gjithë aktiv, megjithatë ndodh ndërprerja e rrjetit kompjuterik, ose ndërprerje tjera, që ndalojnë punën..

2. Procesi kalon nga gjendja e “Ekzekutimit” në gjendjen i “Gatshëm”, nëse i kalon koha procesorike e ndarë (time-sharing), atëherë procesi kalon në listën e proceseve që presin sipas prioritetit.
3. Procesi kalon nga gjendja i “Gatshëm”, në gjendjen e “Ekzekutimit” kur sistemi është rregulluar dhe është i lirë dhe mund të ekzekutoj punët e parashikuara sipas sportelit përkatës, dhe procesit të vështuar (zgjidhet nga lista e pritjes, sipas një kriteri dhe ekzekutohet)
4. Procesi kalon nga gjendja e “Bllokimit” në gjendjen i “Gatshëm”, kur vinë deri te resurset e nevojshme dhe është i gatshëm për punë vijuese, por procesori momentalisht nuk është i lirë, prandaj kalon në listën e pritjes (për shembull: një punëtor administrimi i ka përfunduar koha e punës, dhe pret zëvendësimin sipas orarit të planifikuar, dhe tani procesi mund të vazhdoj me punën, është i gatshëm, por procesori momentalisht është i zënë me ekzekutimin e ndonjë procesi të dytë, prandaj duhet patjetër te pres në radhë, derisa të gjithë punëtorët të kalojnë për shembull në ndërrimin tjetër etj.)

Te disa sisteme dhe modele të administrimit publike, proceset mund të jenë të suspenduar (suspended). Në këtë mënyrë fitohen edhe dy gjendje:

- Procesi është i “Suspenduar” dhe i “Gatshëm” (nëse ka ardhur deri te suspendimi në gjendjen i gatshëm). Rasti është kur sportelisti në administrimin publik, kalon nga gjendja e bllokuar në gjendjen i gatshëm, për të vazhduar me punën dhe me programin të cilin e ka të instaluar në kompjuterin e caktuar.
- Procesi është i “Suspenduar” dhe i “Bllokuar” (nëse ka ardhur deri të suspendimi në gjendjen e bllokimit). Procesi dhe me këtë edhe puna e sportelistit mund të suspendohet përkohësisht nëse, kemi shmangie nga programi, dhe nëse paraqitet probleme të natyrave të tjera, me çka kërkon ndihmë nga sektori i teknologjisë informative (TI), për të ndrëhyrë në sistem dhe për të rregulluar eventualisht problemet e paraqitura. Pas eliminimit të problemit, sistemi kalon në hapin i “I Gatshëm”, që pastaj të kaloj edhe në hapat tjerë më lart, drejt kompletimit dhe përmbushjes së detyrave tjera, për shërbim ndaj klientëve, në varshmëri nga

shërbimi që u ofrohet (për shembull, puna e sportelit në postë; puna e sportelit të shërbimeve të drejtorisë së të hyrave publike; puna e sporteleve të pranimit të dokumentacionit nga klientët sipas fushave të caktuara të shërbimit të projektuar; puna e sporteleve të shërbimeve pagesore, për ujin, rrymën; shërbimet pagesore për transfer të parave etj.)

Në vijim është dhënë diagrami me dy gjendjet tjera:




Fig. 3.4 Gjendja e procesit, me shtimin e gjendjes së suspenduar. Kur punëtori administrativ në sportel kërkon ndihmë nga sektori i teknologjisë informative.

Procesi i cili është i suspenduar, ndalon që të garoj për resurset dhe resurset që i merr bëhen të lirë, por edhe mëtej mbetet proces, sepse pas kësaj faze kemi kalim në gjendjen i “i gatshëm”, pasi të kryhen intervencat për eliminimin e gabimeve eventuale në sistemin e menaxhimit të të dhënave dhe kryerjen e riparimeve të caktuara.

Procesi i cili është në gjendje të suspenduar dhe i bllokuar kalon në gjendjen i suspenduar i gatshëm, nëse bëhet i gatshëm, d.t.th, mund të vazhdoj me punën e rregullt, duke përmbushur kërkesat e shërbimit të caktuar.

PAMJE E QEVERISJES SË DREJTËPËRDREJT E SPORTELEVE DHE POZICIONET HAPËSINORE

POZICIONI I OPTIMIZUAR PËR SHËRBIME ADEKUATE DHE SISTEMI I TEKNOLOGJIVE KOMPJUTERIKE

Në vijim kemi disa pamje të pozicionit të vendosjes hapësinore¹.




Fig.3.5. Hapësira për menaxhim të klientëve. Pozicioni hapësinor për shërbime dhe mundësia e mbushjes së fletëpagesave të ndryshme dhe shërbime plotësuese

Në vijim është dhënë pjesa akomoduese e stafit menaxhues dhe akomodimi i pajisjeve të ndryshme elektronike (kompjuterët, printerët, post terminalët e ndryshëm, etj).

¹ Foto të realizuara drejtëpërdrejtë-Posta e Maqedonisë Veriore, filiali Tetovë (pamje të tilla kanë edhe postat tjera)



Fig.3.6. Pjesa e brendshme, pozicionimi i punëtorëve të sporteleve



Fig.3.7. Pjesa e brendshme, aty ku pozicionohen udhëheqësit e sporteleve, me të gjitha pajisjet ndihmëse.

Në figurën vijuese është dhënë aspekti i planifikimit të shërbimit në administratën e shërbimit në pozicionin e menaxhimit të dokumentacioneve të ndryshme dhe pamjet hapësinore që vendosja e pajisjeve të teknologjisë informative të krijojnë mundësi më të mirë menaxhuese, në aspekt të punëtorëve të sporteleve dhe në aspekt të vet klientëve të shfrytëzojnë këto resurse.



Fig.3.8-Paraqitja e pjesës hapësinore, për menaxhim me shërbimet




Fig.3.9-Sistemi i kontrollit të shërbimeve dhe tërësia e elementeve si pjesë e integruar e këtij sistemi

Pamja e brendshme e stafit menxhues administrativ në përpunim të dokumentacioneve si dhe vendosja e harmonizuar e teknologjisë informative (kompjuterëve, printerëve, tavolina e punës, numëruesi të ndryshëm programor, terminale etj.

PROCESI I VLERËSIMIT TË APLIKIMIT TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE PËR QEVERISJEN E MIRË NË RMV

Në kontekstin e “Evaluimit” parashikohet të përcaktohet se çfarë lloji të evaluimit do të përdoret. Në rastin konkret këtu është realizuar metoda e hulumtimit (sasiorë /cilësorë). Poashtu këtu përdoret një dokumentacion i verifikuar dhe i krijuar në formë të një modeli për evaluim, duke përfshirë të gjitha pikat karakteristike të vlerësimit. Përdorimi i raporteve, marrja e mostrave, pastaj edhe procesi i vendosjes së mundësisë së deklaramit edhe të klientëve (ose kompanive të cilët do të përdorin këto shërbime).

Si burime kryesore janë aplikacionet aktuale dhe krahasimi i tyre me një model të ri dhe të modifikuar. Këtu përgjithësisht mblidhen të gjitha të dhënat, duke parashtruar të gjitha pyetjet në aspekt të trajtimit të përgjithshur të aplikacionit dhe aspekti i ndjeshmërisë së punës gjatë përdorimit praktik.

- Evaluimi bëhet në një periudhë prej 1-2 muaj, duke ofruar mundësi anketimi/intervistat përmes qasjes elektronike - online.
- Konkretisht, përmes emailit u dërgohet klientëve të përzgjedhur, ose mund të jenë insititucione arsimore, kompani ose qeveria etj.
- Si informacion të kthyer i kemi të dhënat e grumbulluara me të cilat në mënyrë statistikore mund ta paraqesim përmes vlerësimeve analitike, ose përmes paraqitjes grafike.
- Në Intervistim marrin pjesë edhe persona profesional, persona fizik, persona juridik, që nuk kanë përvojë me këto platforma.
- Si karakteristikë këtu mund të shtohet se si pjesë e evaluimit është mirë të marrin pjesë persona nga administrimi publik, psikolog për të vlerësuar edhe aspektin e vizualitetit dhe aspektin psikologjik të gjendjes së personave në momentin e përdorimit të këtyre ndryshimeve dhe përshtatshmëria për platformën e re të modifikuar.

- Gjatë evaluimit, theksohen të gjitha burimet e mbledhjes së të dhënave, teknikat e përdorimit të mostrave, metodat e mbledhjes së të dhënave (p.sh. sondazhet, intervistat kryesore të informatorëve, diskutimin e stafit), analizën e të dhënave dhe dokumentacionin.
- Këtu gjithashtu mund të zgjedhen ose përfundohen fushat kryesore të hetimit si:
 - Ndikimi tek përfituesit dhe shoqëria
 - Pjesëmarrja dhe shoqëria më e gjerë
 - Përzgjedhja dhe përpunimi i përfituesve
 - Menaxhimi i projektit dhe procesi i përgjithshëm i zbatimit




Fig.3.10-Strategjitë e arritjes së Evaluimit dhe kontrollit-dhe plani strategjik

KAPITULLI 4

PROCESI I VLERËSIMIT DHE IMPLEMENTIMIT TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË FUNKSION TË QEVERISJES SË MIRË NË RMV

Një udhëzues i qartë, konciz, i shkurtër dhe megjithatë i plotë për të shkruar raportin vlerësues afatmesëm ose përfundimtar për një projekt të çdo lloji. Format i është gjithashtu në dispozicion në formatin MS Word dhe mund të merret këtu- Modeli i Raportit të Vlerësimit.

PROCESI I VLERËSIMIT TË IMPLEMENTIMIT TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË FUNKSION TË QEVERISJES SË MIRË NË RMV (Republikën e Maqedonisë së Veriut)							Data e Projektit: 14. 11. 2020
Emri i projektit:							
Menaxhimi i aplikacionit të ndërmarrjeve dhe procesi i modifikimit							
Projektuesi: Bestar Zeqiri							
Ju lutem vlerësoni atributet në vijim prej 1 deri 5. Ku 1 - shumë pak, 2 - pak, 3 - mesatarisht, 4 - më mirë se mesatare, 5 - jashtëzakonisht shumë.							
	Përshkrimi	5	4	3	2	1	Komente
1	Sa jeni të kënaqur me sistemin Tuaj të teknologjive informative (TI etj) në sektorin Tuaj të administrimit publik?						
2	Sa jeni të kënaqur me sistemet e mëparshme në sektorin e administrimit publik Tuaj?						
3	A jeni të njoftuar me aktivitetet e reja të programit?						
4	A janë mangësitë arsye të modifikimit?						
5	A janë të dhënat e aplikacionit të ri sipas propozimit?						
6	Sa ndjeheni komod gjatë përdorimit?						

7	Sa është lehtësia e manaxhimit?						
8	Në çfarë mase arrihen objektivat Juaj?						
9	Sa është relevanca e përmbushjes së kërkesave?						
10	Cila është shkalla e efektivitetit të shoqëria/njerëzit?						
11	Si është përshtypja në lidhje me efikasitetin?						
12	A është zgjedhur alternativa më e mirë për administrimin publik?						
13	Si ju duket qëndrueshmëria e sistemit për grupin tuaj të punës në këtë sektor të administrimit publik?						
14	A e plotëson strategjinë tuaj në aplikim ky version i ri i teknologjisë informative?						
15	A mendoni se krijon një lidhje më të mirë organizative në administrimin publik të sektorit Tuaj?						
16	A duhet të zhvillohet edhe më tutje projekti për përshtatshmëri të modeleve të reja?						
17	A mendoni se mund të shtohen edhe pika tjera në kuadër të teknologjisë TI të përdorur në këtë sektor të administrimit publik?						
Koment (Ju lutem shënoni ndonjë koment sipas dëshirës Tuaj):							

Tabela 3.2-Procesi i vlerësimit të implementimit të teknologjisë informative në funksion të qeverisjes së mirë në RMV




Fig.3.11-Evaluimet, dhe grafiku karakterstikë-rezultatet kthyses

Evaluimet për 20 të intervistuarit sipas programit Google Forms e dhënë në vijim:

Realizimi i “Vlerësimet” me “Google forms” (pjesë e programit në figurën në vijim)

Intervistimi -Aplikimi i teknologjive moderne në administratën publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut

This form is automatically collecting email addresses for SEE University users. [Change settings](#)

Emri mbijetës *

Short answer text

Ju lutem vlerësoni atributet në vijim prej 1 deri 5. Ku 1 - shumë pak; 2 - pak; 3 - mesatare; 4 - më mirë se mesatare; 5 - jashtëzakonisht shumë.

Short answer text

Sa jeni të kënaqur me sistemin Tuq të teknologjive moderne (TI) në sektorin Tuq të administrimit publik?

☐ 5
☐ 4
☐ 3
☐ 2
☐ 1
☐ Other...

Sa jeni të kënaqur me shërbimet e ofruara në sektorin e shërbimeve publike Tuq? *

☐ 5
☐ 4
☐ 3
☐ 2
☐ 1
☐ Other...

Fig.3.12-Pamja fillestare e “Google forms”-në procesin e evaluimit

VLERËSIMI-INTERVISTIMI

Questions Responses 0 Total points 0

Other...

Sa i përket të përdorimit me sistemin e ri, ju lutemi vlerësoni nivelin e përdorimit të kësaj funksioni? *

5
4
3
2
1
Other...

A jeni të ngjashëm me sistemin e ri në përdorim? *

5
4
3
2
1
Other...

A janë mangësitë e reja të modifikimit? *

5
4
3
2
1
Other...

Fig.3.13-Paraqitje e pyetjeve karakteristike sipas radhitjes tabelare, për shërbimin e sistemit të mëparshëm

VLERËSIMI-INTERVISTIMI

Questions Responses 0 Total points 0

Other...

A janë të dhënat e aplikacionit të ri sipas propozimit? *

5
4
3
2
1
Other...

Sa ndjeheni komod gjatë përdorimit? *

5
4
3
2
1
Other...

Në çfarë mase arrijen objektivat tuaja? *

5
4
3
2
1
Other...

Fig.3.14-Parashtrimi i pyetjes sipas vlerësimit me “notën përkatëse” dhe përshtatja me propozimet

VLERËSIMI-INTERVISTIMI

Questions Responses 0 Total points: 0

Se është relevante e përbërësja të kësaj? *

☐ 5
☐ 4
☐ 3
☐ 2
☐ 1
☐ Other...

Cila është shifra e efektivitetit të shprehur/hiper? *

☐ 5
☐ 4
☐ 3
☐ 2
☐ 1
☐ Other...

Si është përbërësja në lidhje me efikasitetin? *

☐ 5
☐ 4
☐ 3
☐ 2
☐ 1
☐ Other...

Fig.3.15-Pyetjet që ndërlidhen relevancën- efikasiteti e përdorshmërisë praktike

VLERËSIMI-INTERVISTIMI

Questions Responses 0 Total points: 0

A është zgjedhur alternativa më e mirë për administratën publike? *

☐ 5
☐ 4
☐ 3
☐ 2
☐ 1
☐ Other...

Si ju duket qëndrueshmëria e sistemit për grupin tuaj të punës në këtë sektor të administratës publike? *

☐ 5
☐ 4
☐ 3
☐ 2
☐ 1
☐ Other...

A e plotëson strategjinë tuaj në aplikim ky version i ri i teknologjisë moderne? *

☐ 5
☐ 4
☐ 3
☐ 2
☐ 1
☐ Other...

Fig.3.16-Pyetjet për evaluim, në kuadrin e përzgjedhjes së alternativës më të mirës, sipas kërkesës, dhe shtimi i shërbimeve




Fig.3.17-Parashtrimi i pyetjeve evaluese, dhe mundësi të krijimit të organizimit më të mirë në administrimin publik

KRIJIMI DHE MENAXHIMI I DATABAZËS PËR QEVERISJEN E MIRË ME TEKNOLOGJINË INFORMATIVE NË RMV

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE KRYESORE TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË NJË INSTITUCION PËRKATËS ME SHËRBIME PËR SHFRYTËZUESIT

Në vijim është paraqitur databaza e realizuar në MS Access 2016 (e njëjta mund të implementohet edhe në versione tjera të MS Access). Poashtu, ky komunikim është i rëndësishëm sepse mund të implementohet në institucione të ndryshme me vlefshmëri universale aplikuese. Në qendër të vëmendjes është ndërlidhja e teknologjisë informative me një kontekst të qeverisjes së mirë e institucionale, si dhe realizimi i funksionaliteteve të ndryshme në aspekt të çfarëdo lloj të punëve të duhet të procesohen.




Fig.3.18-Databaza e realizuar në MS Access, për administrimin publik të sektorit përkatës

Në figurën e mësipërme, fillimisht, janë krijuar tabelat relevante: Administrimi publik, Punëtori Administrativ-Kompetencat, Gjinia, Shteti, Komuna, Pozicioni në punë, etj. Për të gjitha këto tabela gjithashtu janë krijuar edhe fushat karakteristike të cilat përmbushin kërkesën funksionale të një administrimi të suksesshëm.

Pas krijimit të tabelave janë krijuar edhe format: Administrimi publik, Punëtori Administrativ-Kompetencat, Gjinia, Shteti, Komuna.

Forma Gjinia, e cila ndihmon ndërlidhjen me formën qendrore, sepse njëherë të dhënat shkruhen dhe shfrytëzohen për rekorde të ndryshme. Gjithashtu, Gjinia mund të shtohet, fshihet ose të modifikohet,




Fig.3.19-Administrimi publik-forma për përfshirjen e gjinisë së punëtorit etj

Forma Komuna, e cila ndihmon ndërlidhjen me formën qendrore, sepse njëherë të dhënat shkruhen dhe shfrytëzohen për rekorde të ndryshme. Gjithashtu, emri i komunave mund të shtohet, fshihet ose të modifikohet.




Fig.3.20- Administrimi publik-forma për përfshirjen e Komunës së punëtorit etj

Forma “Shteti”, e cila ndihmon ndërlidhjen me formën qendrore, sepse njëherë të dhënat shkruhen dhe shfrytëzohen për rekorde të ndryshme. Gjithashtu, emri i shteteve mund të shtohet, fshihet ose të modifikohet,




Fig.3.21- Administrimi publik-forma për përfshirjen e Shtetit të punëtorit etj

Për të ndërlidhur të gjitha këto njësi, duhet që të gjitha tabelat të ndërlidhen me formën kryesore, përmes “combo box” që fillimisht konfigurim realizohet përmes “query” dhe aty gjithësesi ndodhet SQL kodi. Në këtë pjesë, ndërfitet pjesa e ndërlidhjes së tabelave me tabelën kryesore.




Fig.3.22-Pyetësi- Administrimi publik-pyetësi (query) për ndërlidhje të tabelave etj

Të gjitha rezultatet mund të shihen edhe në raportin final, nëse për këtë paraqitet nevoja për të krijuar raporte të tilla, si për shembull, në vijim është dhënë një pamje,




Fig.3.23-Raporti final, gjatë çdo aktiviteti në administrimin publik (një lloj i raportit)

Por, fokusi kryesor është vendosur në formën, Punëtori Administrativ-Kompetencat. Në këtë formë janë ndërlidhur edhe format tjera në formë të “scroll down”, ashtu që krijohet lehtësi menaxhuese e të gjitha resurseve të nevojshme, si në vijim.

The screenshot displays the Microsoft Access interface. The title bar indicates the database is 'Menaxhimi i databazes-Bestar Zeqiri'. The ribbon includes 'File', 'Home', 'Create', 'External Data', and 'Database Tools'. The 'All Tables' pane on the left lists several tables and queries, with 'Punëtori Administrativ-Kompetencat' highlighted. The main form, 'Administrimi-Kompetencat-Qeverisja', contains the following fields and controls:

- Emri**: Text box with value 'X'
- Shteti**: Dropdown menu with value 'Republika e Maqedonisë së Veriut'
- Mbiemri**: Text box with value 'Y'
- Statusi i punes i regullt**: Checkmark box (checked)
- Pozicioni ne pune**: Dropdown menu with value 'Administrator'
- Telefoni**: Text box with value '(070) 234-225'
- Adresa**: Text box with value 'Rruga ..101,'
- Shenime**: Text box with value 'Menaxhimi i punes se nje punetori. Koha e caktuar sipas ndërrimeve në punë'
- Gjinia**: Dropdown menu with value 'Mashkull-M'
- Foto**: Image box showing a person's photo
- NumriAme**: Text box with value '1099647000018'
- Web site**: Text box with value 'www.seeu.edu.mk'
- Buxheti**: Text box with value '\$500.00'

At the bottom of the form, there are buttons for 'Administrata publike', 'Komuna', 'Shteti', 'Gjinia', 'Pozita në punë-Sistemi', 'Sektori administrativ', 'Printo Formën', and 'Dil nga Forma'. The status bar at the bottom shows 'Records: 1 of 1' and 'No Filter'.

Fig.3.24-Forma e përgjithësuar e menaxhimit të databazës për qeverisjen e mirë me të dhënat

Në formën e përgjithësuar mund të paraqiten të gjitha fushat relevante, ku mund të vendosen të dhënat, dhe të bëhet përditësimi i të dhënave ditore, javore etj, sipas kërkesës së institucionit të caktuar.

Poashtu në në këtë formën është parashikuar edhe vendosja e butonëve ndihmës për kalim nga një formë në tjetrën. Poashtu këtu jepet edhe mundësia e daljes nga forma, shtypja e të dhënave etj.

PËRFUNDIM

Në përgjithësi, proporcionet më të larta të ndikimeve pozitive nga TI shoqërohen me efikasitetin dhe racionalitetin në aspekt të qeverisjes së mirë. Incidencat më të larta të ndikimeve negative kanë tendencë të përfshijnë efektet më subjektive të TI mbi njerëzit, në rolet e tyre si qytetarë ose si institucione publike. Është për tu theksuar se ekzistojnë relativisht pak studime të bazuara, empirike mbi ndikimet e TI në administrimin publik. Ky punim kryesisht fokuset dhe përqendrohet në njësi të nivelit të qeverisjes së mirë në nivel të administrimit publik, në institucione me performancë të caktuar dhe teknologjisë informative (duke nënkuptuar teknologjinë TI, telekomunikuese dhe resurset tjera elektronike që ndihmojnë me procesin e menaxhimit të administrimit publik). Për më tepër, ky punim gjithashtu ofron zgjidhje për qeverisjen që të menaxhohet sipas parimeve të qëndrueshmërisë dhe rritjes së balancuar. Teknologjia informative mund të kursen miliona për buxhetet e administrimit publik në funksion të qeverisjes së mirë në të gjithë botën dhe ato duket se janë shumë atraktive, funksionale dhe tërheqëse të punonjësit. Teknologjia informative është thelbësore për funksionimin e duhur të administratës moderne publike dhe menaxhimit të sektorit shtetëror publik por edhe privat. Aspekti i rritjes së përdorimit të Internetit dhe zgjidhjeve të informacionit dhe komunikimit, ndihmojnë detyrat tona të përditshme, shumë qeveri në botë po përkrahin risitë dhe zgjidhjet inovative për detyrat rutinore, siç janë sigurimi i informacionit, verifikimin e nënshkrimeve në dokumente të rëndësishme.

Në temën e masterit është realizuar specifikimi konkret i përfaqësimit të administrimit, përmes teknologjisë informative në funksion të qeverisjes së mirë në RMV. Për këtë është dashur që të realizohen një varg analizash, grumbullime informacionesh, në drejtim të nxjerrjes së rezonimeve konkrete në lidhje me gjendjen aktuale në RMV. Pasi janë bërë këto analiza, vazhdohet me principin e krahasimit të sistemeve të ndryshme në një kornizë më të gjerë, qoftë rajonale ose ndërkombëtare me qëllim, të vendosjes së një modeli bashkëkohor për çështje të e-qeverisjes sa më funksionale përmes teknologjisë informative. Për të vështuar dhe për të nxjerrë përfundime konkrete është e nevojshme krahasimi i punës së sistemeve të ndryshme,

të cilët ofrojnë performancën e tyre. Është krijuar baza e të dhënave (aplikacion), si qasje praktike në lidhje me tezën e masterit. Por gjithësesi si pikë referente është edhe aspekti i optimizimit të punës, duke përshkruar strukturën e modelit, në aspekt të administrimit, dhe menaxhimit të resurseve.

Qëllimi i tezës së masterit është poashtu ndërlidhja e administrimit publik realizimi i funksionaliteteve të ndryshme. Ardhmëria e kësaj ndërlidhje është shumë e rëndësishme (për shembull në disa shtete realizohet menaxhimi i votimit online). Pra, nëse në të ardhmen do të krijohet një sistem i digjital, atëherë sigurisht dhe harxhimet do të jenë më të vogla dhe koha e përpunimit të të dhënave është shumë më e shpejt. Duke përdorur konceptin e kornizave teknologjike, ne eksplorojmë supozimet, pritjet dhe kuptimet që posedojnë menaxhuesit në mënyrë që të interpretojnë dhe kuptojnë të dhënat. Menaxhimi i bazës së të dhënave në vazhdimësi kanë nevojë për mbështetje nga teknologjitë informative, që rritin performancën dhe realizojnë optimizimin e punëve në përgjithësi dhe krijojnë një funksion të rëndësishëm për qeverisjen.

BIBLIOGRAFIA

1. Anderson, D., Wu, R., Cho, J.-S., Schroeder, K. E-Government Strategy, ICT and Innovation for Citizen Engagement. 2015.
2. E-Government. Emerald Group Publishing, 2006. Volume 12, Issue 1 of Business process management journal.
3. Toshio Obi. E-governance: A Global Perspective on a New Paradigm. IOS Press, 2007 - 179 pages.
4. Zheng et al., 2016. X.H. Zheng, W. Chen, P. Wang, D.Y. Shen, S.H. Chen, X. Wang, L.Q. Yang. Big data for social transportation. IEEE Transactions on Intelligent Transportation Systems, 17 (3), pp. 620-630. 2016.
5. Electronic Government: Concepts, Methodologies, Tools and Applications. Publisher: Information Science Reference. 2008.
6. Christopher Reddick, Leonidas Anthopoulos. Information and Communication Technologies in Public Administration. 2015.
1. Willcocks and Lester, L. Willcocks, S. Lester. Beyond the IT productivity paradox. European Management Journal, 14 (3) (1996), pp. 279-290. 1996.
2. Van Dijck, 2014. J. Van Dijck. Datafication, dataism and dataveillance: Big data between scientific paradigm and ideology. Surveillance and Society, 12 (2), p. 197. 2014.
3. Shilton, 2012. K. Shilton. Participatory personal data: An emerging research challenge for the information sciences. Journal of the American Society for Information Science and Technology, 63 (10), pp. 1905-1915. 2012.
4. T. Mettler, M. Sprenger, R. Winter. Service robots in hospitals: New perspectives on niche evolution and technology affordances. European Journal of Information Systems, pp. 1-18. 2017.

5. Mettler and Wulf, 2018. T. Mettler, J. Wulf. Physiolytics at the workplace: Affordances and constraints of wearables use from an employee's perspective. *Information Systems Journal*, 29 (1). 2018.
6. Making and Managing Policy: Formulation, Analysis, Evaluation, edited by G. Ronald Gilbert
7. Handbook of Organization Management, edited by William B. Eddy 22. Politics and Administration: Woodrow Wilson and American Public
8. Organization Development in Public Administration, edited by Robert T. Golembiewski and William B. Eddy
9. Handbook on Public Personnel Administration and Labor Relations, edited by Jack Rabin, Thomas Vocino, W. Bartley Hildreth, and Gerald J. Miller
10. Managing Administration, edited by Jack Rabin, Samuel Humes, and Brian S. Morgan
11. State and Local Government Administration, edited by Jack Rabin and Don Dodd.
12. Lodge, M.. Institutional Choice and Policy Transfer: Reforming British and German Railway Regulation. *Governance*, 16(2), 150–178. 2003.
13. Lodge, M., and Wegrich, K. Governing Multi-Level Governance: Comparing Domain Dynamics in German Land-local Relationships and Prisons. *Public Administration*, 88(2). 2005.